

prot 2325
Df. 07.03.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

AKT-MIRATIMI

ORGAN I MIRATUAR

I VLERËSIM KONFORMITETIT.

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit" edhe në Çertifikatat e Akreditimit me Nr. Regjistrimi **TI 050** dhe **CN 015**,

MIRATOJ:

Subjektin:	"UNICERT" shpk.
Me Administrator:	Vjola CANKA
Me Drejtues Teknik:	Gjergji Dasho Mariglen Gjoka
Adresa e subjektit:	Njësia Administrative nr. 7, Rruga Nikolla Jorga, Ndërtesa 1, Apartamenti 42, Zona Kadastrale 8250, Nr. Pas. 5/309 +1-35, Tiranë; Albania.
Cel.:	069 85 68 873
E-mail:	canka.viola@gmail.com

të ushtrojë veprimtarinë si Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK):

Tipi i OMVK-së:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	<u>I. Fusha e inspektimit enp:</u> a) Inspektim i rezervuarëve të GLN-së më të vegjel ose të barabartë me 13 m³ b) Inspektim i rezervuarëve të GLN-së me kapacitet më të madh se 13 m³ c) Inspektim i pajisjeve nën presion stacionare. Tubacionet nën presion. d) Inspektimi i kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë. e) Inspektimi i enëve nën presion kriogjenike. f) Inspektimi i rezervuarëve të hidrokarbureve të lëngët. g) Inspektimi i kokave të puseve.

II. Në Fushën mekanike:

1. Inspektimi i ashensorëve për pasagjerë dhe mallra.
2. Inspektimi i pajisjeve ngritëse Industriale, Vinça:
 - Vinçat lëvizës;
 - Vinçat kullë;
 - Vinçat urë dhe me kambalecë;
 - Vinçat piedistal ofshorë;
 - Vinçat Graifer (eskavator etj.);
 - Pirun ngritës;
 - Transpaletë;
 - Makineri mngitëse;
 - Plartorma të lëvizshme për ngritjen e njerëzve;
 - Transportues Industrialë;
 - Pajisje ngritëse të skenës
3. Inspektim i setit ngritës dhe kontinierëve:
 - Offshore;
 - Të thjeshta

III. Në Fushën elektrike:

- a. Inspektimi i instalimeve elektrike në ambjente të zakonshme;
- b. Inspektimi i instalimeve elektrike në ambjente me rrezik zjarri;
- c. Inspektimi i impianteve mbrojtëse nga shkarkimet atmosferike;
- d. Inspektimi i kabinave elektrike TM/TU;
- e. Inspektimi i dispozitivit diferencial të vendosur në pajisjet, instalimet dhe impiantet elektrike, përfshirë kantjeret e përkohëshme të ndërtimit;
- f. Inspektimi i linjave kabllore TU e TL.
- g. Inspektimi i nënstacioneve dhe impianteve shpërndarëse të TL.

IV. Në Fushën e Çertifikimit të Personelit:

- a. Personat që punojnë me pajisje/instalime nën presion (Grupi A,B,C,D, E, F, G, GJ);
- b. Personat që mirëmbajnë, instalojnë, modernizojnë, modifikojnë ashensorë për pasagjerë dhe mallra (Grupi A, B, C.);
1. Personat që punojnë në impiantet, instalimet, linjat dhe pajisjet elektrike (Grupi A -I, II, III, IV dhe V-, Grupi B, Grupi C, D, E, F).

Rregullat teknike/
standartet e sigurisë së
produktit/pajisjes/instali
mit të vënë në shërbim:

1. Ligji nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”;
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
3. SSH EN 12817:2019;
4. SSH EN 12819:2019;
5. SSH EN 113175:2019;
6. EN 10423:2005 (i ndryshuar);
7. SSH EN 21009-2:2015;

8. SSH EN 14015:2004;
9. Urdhëri i Ministrit Nr. 184, dt. 06.07.2005;
10. Metodë jostandarde "Rregullore e sigurimit teknik për kaldajat e avullit dhe ujit të nxehtë" nëntor 1988;
11. Metodë jostandarde Rregullore "Për projektimin, prodhimin, vendosjen dhe shfrytëzimin e pajisjeve nën presion", viti 1984;
12. VKM nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim";
13. SSH EN 81-21:2018;
14. SSH EN 81-20:2014;
15. SSH EN 81-80:2003;
16. SSH EN 81-1:1998 +A3:2009;
17. SSH EN 81-2:1998 +A3:2009;
18. VKM nr. 1060, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për makineritë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara";
19. SSH EN ISO 10855-3:2018;
20. SSH EN ISO 10855-1:2018;
21. SSH EN ISO 1496-1+A1:2016;
22. SSH EN ISO 17638:2016;
23. SSH EN ISO 17637:2016;
24. "Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike";
25. KTP 15-78 "Instalimet elektrike në ambjentet me rrezik zjarri";
26. KTP 16-78 "Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike";
27. VKM Nr. 245, datë 30.3.2016 "Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara";
28. VKM nr. 482, datë 17.06.2020 "Për miratimin e rregullit teknik "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV".
29. VKM nr. 483, datë 17.06.2020 Për miratimin e rregullit teknik "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV".
30. Standardi ISO/IEC 17020:2012 "Kritere të Përgjithshme për funksionimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim" si një organizëm inspektimi i Tipit A.

Periudha e vlefshmërisë:

Deri më 06.09.2026

Territori i ushtrimit të veprimtarisë:

Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Personi përgjegjës firmosës:

Vjola Canka, Administrator, Menaxh cilësie
Gjergji Dasho, Menaxher teknik
Mariglen Gjoka, Menaxher teknik

Cel: 0698568873
E-mail:
canka.viola@gmail.com

OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:

OMI 029 Rishikim 0

OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë:

1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.

2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrit, Strukturës Administrative Përgjegjëse (SAP)), brenda 10 ditësh, kopje të çertifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e çertifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje çertifikate;
7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo me pak se 10 vjet.
9. Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të.
10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgojë Ministrit (SAP) regjistrin e inspektimeve ose çertifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.
11. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrit, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambjentet ku OMVK ka kryer vlerësim të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më, një apo disa kriteret a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrit pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 06 / 03 /2024

**Zv. KRYEMINISTËR
DHE MINISTRËR**

Belinda Balluku

**Me autorizim
Zv. MINISTRI**

Ami Kozeli

